



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:082824

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05636129

**P.nr.202/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të pandehurit T.V., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas Aktakuzës me propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1288/2020 (2020:0049030) të datës 03.04.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 24.04.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Albana Parduzy, të pandehurit T.V., mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare, avokat Gazmend Ismajli, me datë 26.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri:

T.V., me nofken "S", nga i ati Xh., e ëma F., e vajzërisë H., i lindur më datë ..., në Vushtrri, ku edhe banon ne rrugën "Sh.G", i shkurorezuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse,

Me datën 20.05.2020, në rrugën "H.H.T", në Mitrovicë, i pandehuri pa autorizim posedon substance narkotike, ashtu që njësia policore e kontrolluar të pandehurin dhe ne xhepin e pantallonave të tij kanë gjetur një qese me subsancë narkotike-marihuanë, të njëjtit i është konfiskuar dhe pas ekzaminimit të kësaj substance në laborator te Forenzikës, është konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis-marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 0.49 gram.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 18, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 71, 72 dhe 269 paragrafi 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449 dhe 452 të KPP-së, e:

## G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300.00 (*me fjalë: treqind*) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të pandehurit, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- III. Në mbështetje të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPP-së, nga i akuzuari KONFISKOHEN sendet, dhe atë: Substancë narkotike Marihuanë, në sasi prej 0.49 gram, me përmbajtje Tetrahydrokanabinol (THC) dhe Urdhërohet Policia e Kosovës që të njëjtën ta shkatërrojë, sipas procedurave ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Në bazë të nenit 84 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 86 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 e 1.3 dhe paragrafi 4 dhe 5 të KPRK-së e lidhur me nenin 513 dhe 515 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

### MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK NË LIRI

- I. Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri ndaj të akuzuarit, do të ekzekutohet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, të cilës masë i njëjti do t'i nënshtrohet menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. DETYROHET i akuzuari që t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, në të kundërtën po që se nuk i nënshtrohet këtij trajtimi psikiatrik në liri apo ndërpret trajtimin në mënyrë arbitrare, gjykata konform nenit 86 paragrafi 5 të KPRK-së, mund të shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institutin psikiatrik.
- III. DETYROHET Qendra e Shëndetit Mendor në Mitrovicë, që pas fillimit të trajtimit, të informojë gjykatën çdo 6 muaj duke i paraqitur raportin me shkrim për mbarëvajtjen e këtij trajtimi të detyrueshëm psikiatrik ndaj të akuzuarit duke konstatuar se a është apo nuk është i nevojshëm trajtimi i detyrueshëm psikiatrik ndaj të njëjtit.
- IV. Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik do zgjasë derisa është në fuqi ky vendim gjyqësor dhe për aq kohë sa është nevojshme kjo masë dhe trajtimi i të akuzuarit, por jo me gjatë se tri (3) vite nga koha e shqiptimit të kësaj mase.

V. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, në emër të ekspertizës psikiatrike, shumën prej 440.00 (katërqind e dyzetë) euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

VI. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur Aktakuzën me propozim për masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri PP.II.nr.1288/2020 të datës 03.04.2023 ndaj të akuzuarit T.V. për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 17.01.2024, në të cilën seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë pjesërisht, mirëpo gjykata me aktvendim procedural ka refuzuar pranimin e fajësisë duke u bazuar në nenin 242 paragrafi 4 e lidhur me nenin 513 të KPP-së, meqenëse i pandehuri nuk kishte pranuar fajësinë ashtu siç parashohin dispozitat ligjore dhe gjithashtu ishte propozuar që ndaj të pandehurit të urdhërohet ekzaminimi psikiatrik, gjykata kishte konstatuar se është e nevojshme të bëhet ekzaminimi i të pandehurit si dhe të dëgjohet edhe eksperti i psikiatrisë, për arsye sepse i pandehuri kishte paraqitur dëshmi se vuan nga një çrregullim mendor.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 24.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Albana Parduzy, i pandehuri T.V., mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare, avokat Gazmend Ismajli, Ekspertja e psikiatrisë forenzike, Dr. Valbona Blakaj Ramadani nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë (IPFK), dhe dëshmitarët A.Z dhe F.V.

Gjykata fillimisht në këtë seancë ka kërkuar mendimin e ekspertit - psikiatrit Dr. Valbona Blakaj Ramadani lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të të akuzuarit .., a është i aftë për t'iu nënshtruar gjykimit dhe e njëjta ka deklaruar se, pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë sot në gjykatë para fillimit të seancës gjyqësore në lidhje me pjesëmarrjen e të akuzuarit në seancë, ka theksuar se i njëjti është në gjendje të përmirësuar shëndetësore andaj edhe është në gjendje të marrë pjesë në seancë gjyqësore.

Pas dëgjimit të Ekspertit- Psikiatrike Dr. Valbona Blakaj Ramadani, gjykata është bindur se i akuzuari është i aftë për ta kuptuar gjykimin andaj të akuzuarin, hollësisht e njoftoi me të drejtat e tij procedurale në cilësinë e palës së akuzuar dhe i njëjti ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e tij dhe se në këtë çështje penale ka deklaruar se dëshiron të mbrohet përmes mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare, avokat Gazmend Ismajli.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimi të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare,

pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, dhe i ka propozuar gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë dhe këtë pranim ta merr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit dhe njëkohësisht përveç dënimit të shqiptohet edhe masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri në Qendrën e Shëndetit mendor ne Mitrovicë, në kuptim të nenit 514 par.3 të KPP-së lidhur me nenin 84 par.1 nën par.1.2 dhe 86 par.1 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të pandehurit T.V., avokat Gazmend Ismajli, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: duke marr parasysh konstatimet e ekspertës i ka propozuar gjykatës që tani për tani të refuzoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe lidhur me këtë çështje i njëjti të deklarohet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata e ka refuzuar pranimin e fajësisë nga i pandehurit ... në shqyrtim gjyqësor dhe kjo duke u bazuar në nenin 322, 242 dhe 513 të KPP-së. Dispozita e nenit 513 të KPP-së, përcakton se masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik shqiptohet pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë, përveç personave tjerë, thirret edhe eksperti ose psikiatri nga institucioni i kujdesit shëndetësor të cilit i është besuar kryerja e ekzaminimit psikiatrik mbi aftësinë mendore të pandehurit.

Në fjalën hyrëse, prokurori i shtetit ka theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale si në aktakuzë e cila do të vërtetohet edhe nga dëshmitë e dëshmitareve dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Në fjalën hyrëse, mbrojtësi i të pandehurit T.V., avokat Gazmend Ismajli, ka theksuar se duke marrë parasysh se në kohën e kryer së pretenduar të veprës penale, ekzpertiza ka konstatuar se i pandehuri ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore andaj i ka propozuar gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Në cilësi të ekspertit të psikiatrisë, në shqyrtim gjyqësor është dëgjuar Dr. Valbona Blakaj Ramadani, e cila ka theksuar i ekzaminuari T.V. vuan nga çrregullimi mendor të quajtur çrregullimi kufitar - borderline i cili në bazë të klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet si ICD 10 e bartë shifrën F60.3, i cili është një çrregullim që përcjellët me përmirësime dhe përkeqësime të gjendjes e cila karakterizohet me të menduarit, reagime të vullshme emocionale, probleme me raporte ndër njerëzore, ndarje të njerëzve dhe situatave plotësisht të mira ose të këqija, ka nuanca ndërmjet të dyjave dhe për të mbajtur gjendjen e qëndrueshme emocionale nevojitet përdorim i rregullt i terapisë sipas udhëzimeve të mjekut psikiatër. Tutje ka shtuar se sa i përket momentit në kryerjen e veprës penale ka qenë në një fazë të përkeqësimit të gjendjes së tij si pasoj e mos përdorimit të terapisë, andaj aftësia e tij e të kuptuarit dhe kontrollit të veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale. Më tej ka shtuar se i njëjti ka vazhduar më vonë trajtime të rregullta, gjendja e tij ka qenë e përmirësuar më stabile andaj edhe propozimi i ekspertëve të komisionit vlerësues ka qenë që i njëjti të vazhdoj me këtë trajtim në mënyrë që të mos vije deri të përkeqësimi i gjendjes së tij dhe po ashtu i njëjti është në terapi ampulare një herë në tre javë e cila edhe bënë lirim gradual në organizëm të terapisë së nevojshme.

Pas dëgjimit të Ekspertit- Psikiatrit Dr. Valbona Blakaj Ramadani, lidhur me gjendjen e shëndetit mendor të pandehurit, gjykata i ka dhënë mundësinë edhe një herë të njëjtit që të deklarohet lidhur me fajësinë, ashtu që i akuzuari lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se ashtu siç ka theksuar

dhe në shqyrtimin fillestar edhe në këtë seancë të shqyrtimit gjyqësor, e pranon fajësinë për veprën për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: mbetet pranë deklarimit si më lartë sa i përket pranimin të fajësisë dhe po ashtu edhe sa i përket propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm në liri ndaj të pandehurit T.V..

Lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit i ka propozuar gjykatës që të pranohet pranimi i fajësisë, i cili pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimit me mua si mbrojtës dhe si rezultat i provave që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata, pas dëgjimit të ekspertit të psikiatrisë forenzike në shqyrtim gjyqësor, dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, mbrojtësi i të pandehurit, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 322 dhe 242 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër të referencës 2020-BC-431 të datës 25.05.2020; Procesverbali i marrjes në pyetje për të pandehurin T.V., me numër të referencës 2020-BC-431 i datës 25.05.2020; Vërtetimi mbi marrjen e sendeve, me numër të referencës 2020-BC-431, i datës 25.05.2020; Raporti i oficerit A.Z., me numër të referencës 2020-BC-431, i datës 25.05.2020; Raporti i oficerit S.V., me numër të referencës 2020-BC-431, i datës 25.05.2020; Raporti i Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzike, me numër AKF/2023-0871/23-798, i datës 21.03.2023; Dëgjimi i ekspertit të psikiatrisë, Dr. Valbona Blakaj Ramadani në shqyrtim gjyqësor si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i 'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se, meqenëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila gjen mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe gjendja faktike është vërtetuar në tërësi dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'i shqiptoj një dënim duke i marr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese si dhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Mbrojtësi i të pandehurit, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe deklarimit ekspertit gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu duke marr parasysh gjendjen shëndetësore në momentin e kryerjes penale, periudhën e ekzaminimit dhe trajtimit adekuate, në seancën e shqyrtimit fillestar i njëjti ka deklaruar se asnjëherë nuk do të merr asnjë veprim ndaj

prindit të tij, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj propozimin e prokurorisë për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri.

I akuzuari, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtësit dhe ka shtuar se jam penduar për veprën që e kam kryer, jam baba i pesë fëmijëve dhe e lus gjykatën të më shqiptoj një dënim më të butë dhe gjithashtu ka premtuar se nuk do të përsërisë më veprime të tilla dhe po ashtu ka siguruar se do të përgjigjet në përpikëri masës së trajtimit të cilën do ta caktoj gjykata.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Gjykata, si rrethana rënduese, ka vlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale për faktin se veprat e tilla penale janë gjithnjë e më të shpeshta në vendin tonë. Ndërsa si rrethana lehtësuese, ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari, faktin se i njëjti ka shprehë keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisë më veprime të tilla, rrethanat personale e familjare pasi që i njëjti është baba i një fëmije dhe gjithashtu faktin se siç është vërtetuar, i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale, ka qenë në shkallë esencialisht të zvogëluar mendore.

Gjykata ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, ashtu që për të pandehurin T.V., sa i përket veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për zbutjen e dënimit në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, janë plotësuar kushtet për shqiptim të dënimit nën minimumin e paraparë me ligj.

Andaj mbi bazën e këtyre rrethanave të përcaktuara si më lart, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata duke marrë për bazë rrethanat dhe gjendjen e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprave penale e mbi të gjitha rekomandimet dhe propozimin e ekspertës Dr. Valbona Blakaj Ramadani vlerësoi si të domosdoshme vendimin mbi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, me qëllim të rehabilitimit të të akuzuarit në mënyrë që të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit që i njëjti mos të kryej më vepra penale dhe përfundimisht të rehabilitohet, të mos jetë i rrezikshëm për rrethin ku jeton dhe në këtë mënyrë të eliminohet rreziku i përsëritjes së veprave penale. Gatishmëria dhe vullneti i të akuzuarit për tu trajtuar, dhe mundësia që përmes këtij trajtimi i njëjti mund të rehabilitohet dhe kështu të vazhdon jetën e tij normale, kanë bindur këtë gjykatë se kjo masë është e domosdoshme, andaj edhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi përkitazi me masën e trajtimit detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata në rastin konkret zbatoi nenin 515 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale në të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata merr aktgjykim ndaj personit i cili ka kryer vepër penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, në atë aktgjykim ajo gjithashtu shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë nga nenet 85 dhe 86 të Kodit Penal.”.

Gjykata, vendimin për konfiskimin e substancës narkotike të gjetur tek i akuzuari, e mori konform nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-së i cili parasheh: ”Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen” e lidhur me nenin 276 par.2 nën par. 2.4 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor dhe shpenzimet e ekspertizës psikiatrike, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.202/2023, datë 29.04.2024**

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi lejohet e drejta në ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur palët e pranojnë aktgjykimin me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palën dhe gjykatën.